**VENDIM**
**Nr. 511, datë 17.7.2019**

# PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 78/39, ZONA KADASTRALE 3184, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 78/39, zona kadastrale 3184, fshati "Rinia", njësia administrative "Katund i Ri", Bashkia Durrës, sipas certifikatës së pasurisë dhe hartës treguese, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e statusit të resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 78/39, zona kadastrale 3184, fshati "Rinia", njësia administrative "Katund i Ri", Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Qarkut Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës në qarkun Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

# ÇERTIFIKATË

PËR VËRTETIM PRONËSIE

1165424

Zyra e Regjistrimit DURRES Zona Kadastrale Nr. 3184

Numri i Pasurisë 78/39 Volumi 11 Faqe 122

Adresa e Pasurisë RINIA

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 15876 m²

Nga kjo : Sa Truall — Nga kjo : Sa Ndërtesa —

Nga pallat : Kuota e pjesëmarrjes — %

## KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| BUJAR | | DOMI | B | RINIA - DURRES |
| IRENA | | DOMI | B | RINIA - DURRES |

- është pronar i
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart 78/39
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V 78/26 L 78/8 J P 8

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 10-11-2015 Nr. 25521

Data e lëshimit të çertifikatës

11. 11. 2015

Lëshuesi i çertifikatës

REGJISTRUESI

( Gyrbja )

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

DURRES

REGJISTRUESI I RRETHIT

JURGIS CYRBJA

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3184 NR.PASURISE 78/39 Vol. 11 FQ 122

INDEKSI I HARTES K-34-87-(223-C) SHKALLA 1:2500 SIP = 15876m²

ADRESA E PASURISE : Rrethi Durres ~~Q~~/F Rinia

Rr/L – P/G – Sh – K – Ap –

B. KUFIZIME

V. PASURIA Nr 78/26

L. PASURIA Nr 78/8

J. PASURIA Nr –

P. PASURIA Nr 81

C. PRONARI

Bujar Domi etj

D. Data 11 / 11 / 2015 Ora 11⁰⁰



09/06/2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA DURRES

## LEJE ZHVILLIMI

Nr. 321, datë 09.06/2017

Mbështetur ne nenet 7/2 dhe 44, shkronja "a" të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ", i ndryshuar, nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 107 2014, datë 31.07.2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ", i ndryshuar, nenet 9, 10, 10/1 dhe 45 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 " Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit ", i ndryshuar, dhe bazuar në Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës nr. Prot. 4170 , datë 15.05/2017, për leje zhvillimi për në pasurinë me nr. pasurie 78/39, ZK 3184, në pronësi të Bujar dhe Irena DOMI me kufij (V J L P), sipërfaqe 15876 m2 dhe adresë Fshati Rinia , dhe dokumentacionit shoqërues të kërkesës si vijon:

- Prokure per autorizimin e aplikuesit
- Kopje e dokumentit te pronesise
- Projekt-ideja paraprake
- Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht
- Prokure per autorizimin e aplikuesit
- Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht

**VENDOSA:**

1. LËSHIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR në pasurinë me nr. pasurie 78 39, ZK 3184 në pronësi të Bujar dhe Irena DOMI, me kufij (V J L P), sipërfaqe 15876 m2 dhe adresë Rinia, sipas paraqitjes grafike në shkallë të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese që është pjesë përbërëse e këtij vendimi

Distancat nga kufiri i pronës, nga objektet fqinje, nga trupi i rrugës etj. janë Sipas VKM 408 e ndryshuar

2. VLEFSHMËRIA E LEJES

Kjo leje është e vlefshme deri në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të kësaj bashkie me vendim të autoritetit përgjegjës dhe, në çdo rast, deri në ndryshimin e statusit apo kufijve të pronës. Në këto raste, zhvilluesi duhet të aplikojë për leje të re zhvillimi që të mund të pajiset me leje ndërtimi për zhvillimin e pronës.

Dr. D.P.K.Zh.T.

Adhurim Qehajaj ark.

Adhurim Qehajaj Digitally signed by Adhurim Qehajaj Date: 2017.06.09 14:38:30 +01'00'

KRYETARI I BASHKISË

Z. VANGJUSH DAKO

Vangjush Dako Digitally signed by Vangjush Dako Date: 2017.06.09 14:39:02 +01'00'

Tiranë, më datë 24 Tetor 2017

MARRËVESHJE PARAPRAKE BASHKËPUNIMI

*E lidhur ndermjet paleve :*

I. Federata Shqiptare e Futbollit, me seli ne Tiranë, Rruga "Elbasanit", perfaqësuar nga Sekretari I Pergjithshëm z.Ilir Shulku, këtu e në vijim "FSHF"

dhe

II. Kompleksit "Olympic Park Durrës" me perfaqesues ligjor z.Bujar Domi, (ne cilësinë administrator) regjistruar pranë QKB me (NUIS)L414175010, me adresë, Durrës KATUND I RI, Sektor Rinia.

*Të cilët ranë dakort per sa vijon :*

Neni 1

BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje hartohet në bazë dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Rregullimi dhe Interpretimi i sajë, do të bëhet në përputhje me këtë kod dhe me legjislacionin shqiptar të aplikueshem.

Neni 2

OBJEKTI

Objekt I kësaj marrëveshje është realizimi I aktiviteteve të ndryshme sportive (ndeshje dhe stërvitje te Ekipeve Kombëtare te Futbollit) sipas nevojave që FSHF do të ketë pasi Kompleksi "Olympic Park Durrës" të përfundojë dhe të plotesojë të gjitha kriteret dhe standartet e kërkuara nga FIFA dhe UEFA, të cilat janë paraqitur në një projekt pranë FSHF. ***(bashkangjitur kësaj marrëveshje projekti)***

Neni 3

KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES DHE HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje paraprake hyn në fuqi sot më dt. 24.10.2017 dhe do të pasohet me një kontratë bashkëpunimi ku do të percaktohen edhe kushtet financiare për zhvillimin e aktiviteteve të FSHF-së pranë kompleksit "Olympic Park Durrës" pasi ky I fundit përfundon dhe merr miratimin nga Komisioni I Licencimit te Klubeve, pas raportit te paraqitur nga Menaxheri I Licencimit pas inspektimit te kryer në kompleks.

Neni 4

HARTIMI DHE NENSHKRIMI I MARRËVESHJES

Marrëveshja u hartua në dy kopje autentike, nga një për secilën palë.

Palët pasi e lexuan, kuptuan permbajtjen dhe e pranuan, me vullnet të lirë e nënshkruan atë.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 24 Tetor 2017.

"Federata Shqiptare e Futbollit"
Sekretar i Përgjithshëm

z.Ilir Shulku

Kompleksi "Olympic Park Durrës"
Administratori

Bujar Domi

z. Bujar Domi